

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7199
E mërkurë, 29 maj 2024
Çmimi 0.50

KQZ-ja, fushatë për edukimin dhe informimin e votuesve të rinj: Zëri yt, vota jote!



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE



DEPUTETI REÇICA REALIZON VIZITË TË SUKSESSHME NË FINLANDË F. 9

BE-JA PO VËZHGON MASAT E METAS PËR TA LUFTUAR DEZINFORMIMIN PËR ZGJEDHJET F. 2

SARRAZI TAKON OSMANIN DHE KURTIN, TEMË DISKUTIMI MARRËVESHJET E DALA NGA PROCESI I BERLINIT F. 6

RAPORTI I BORRELLIT PËR KOSOVËN MUND TA PËRFSHIJË EDHE MBYLLJEN E BANKAVE NË VERI F. 6

EKONOMI



SKEMA E RE SOCIALE, TRI FAZAT QË DUHET T'I KALOJË NJË FAMILJE PËR TA PËRFITUAR NDIHMËN FINANCIARE NGA SHTETI F. 8

ZKA-ja: KATËR NDËRMARRJE PUBLIKE DHE RTK-JA VAZHDOJNË TË KENË MANGËSI NË FUSHËN E RAPORTIMIT FINANCIAR F. 8

SPORT



ÇEKU: MKRS KA DYSHIME SE PO KEQPËRDORËT LIGJI I SPONSORIZIMIT F. 10

DËSHMIA E DIPLOMATIT AUSTRIAK NË HAGË: NUK DINIM PËR STRUKTURËN E UÇK-së MË 1998, AMERIKANËT E ÇILËSONIN SI TË SHPËRNDARË



Diplomati austriak Jan Kickert, në dëshminë e tij në Speciale, ka thënë se dinim shumë pak për strukturën e UÇK-së. Kickert, i cili ka punuar diplomat në Beograd, ka thënë se amerikanët u

kishin thënë se kjo pjesë ishte misterioze, por që kishin përshtypje se ishte strukturë horizontale dhe e shpërndarë. Po ashtu, ai ka thënë se kishin ndjesinë se zonat e ndryshme të UÇK-së nuk e kishin

strukturën e njëjtë. Ai ka thënë se nuk kanë qenë shumë të interesuar për strukturën e UÇK-së në verën e vitit 1998, por interesi i tyre ishte të gjenin dikë që ta përfshinin në proceset politike

JASHARAJ: QEVERIA KURTI PO ZHVILLON LUFTË TË VAZHUESHME PËR T'I SHUAR SINDIKATAT F. 7



PSE S'PO E NJEH SPANJA KOSOVËN? F. 4-5



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mobi: +377 44 501289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

BE-ja po vëzhgon masat e Metas për ta luftuar dezinformimin për zgjedhjet



BRUKSEL, 28 MAJ - Komisioni Evropian ka thënë të martën se kompania Meta ka marrë masa për ta luftuar përhapjen e dezinformatave në platformat e veta, para zgjedhjeve të Bashkimit Evropian. "Meta ka aktivizuar funksione të reja... 27 panele, nga një për secilin shtet, për ta lejuar diskursin qytetar të palëve të treta dhe për t'i

vëzhguar zgjedhjet", ka thënë një zëdhënës i Komisionit. Muajin e kaluar Komisioni Evropian e ka nisur një hetim rreth dyshimeve për shkelje të rregullave të BE-së nga ana e Metas, duke thënë se Facebook dhe Instagram kanë dështuar ta luftojnë dezinformimin dhe reklamimin me doza mashtrimi.

Komisioni Evropian ka thënë se do t'i monitorojë funksionet e reja të kompanisë, teksa procedurat formale ndaj Metas do të vazhdojnë të zbatohen. Zgjedhjet për Parlamentin Evropian do të mbahen më 6-9 qershor të këtij viti. Shefja e BE-së, Ursula von der Leyen, synon edhe një mandat në krye të bllokut evropian.

Lideri çek përkrash të drejtën e Ukrainës për t'i goditur shënjestrat brenda Rosisë

PRAGË, 28 MAJ - Qeveria e Çekisë ka reaguar në linjë me thirrjen e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg, që Ukraina të lejohet t'i përdorë armët e Perëndimit për të kryer sulme brenda territorit rus. "Si një shtet nën sulm, Ukraina e ka çdo të drejtë t'i përdorë të gjitha mjetet e mbrojtjes", ka thënë kryeministri Petr Fiala të martën në Pragë, duke e përshkruar këtë qëndrim si "thjesht logjik". Sulmet ndaj shënjestrave ushtarake në Rusi, nga ana e Ukrainës, parashihen edhe prej ligjit ndërkombëtar, në kuadër të mbrojtjes, vlerësojnë ekspertë të

ligjeve të luftës. Mirëpo disa shtete të Perëndimit që mbështesin Ukrainën, sikurse Gjermania, kanë doza hezitimi. Këto kryeqytete shqetësohen që nëse Kievi përdor armët e avancuara të Perëndimit për ta sulmuar territorin rus, diçka e tillë do të interpretohet prej Moskës si përfshirje direkte e këtyre shteteve në luftë. Fiala ka thënë se Ukraina po përballet me moment kyç aktualisht, pasi strategjia e forcave ruse për të kryer sulme përgjatë vijës kufitare në veri, në pjesën e Harkivit, mëton të hapë front të ri të luftës.

Aktualisht Republika Çeke është në krye të iniciativës për të blerë 800 000 predha artilerie për Ukrainën prej shteteve jashtë Bashkimit Evropian. Lufta në Ukrainë ka nisur më 24 shkurt të vitit 2022. Presidenti rus Vladimir Putin e quan luftën "operacion special ushtarak" për ta çmilitarizuar Ukrainën. Perëndimi është përgjigjur ndaj Rosisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.



Zelensky nënshkruan marrëveshje të sigurisë me Belgjikën

KIEV, 28 MAJ - Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky e ka nënshkruar të martën një marrëveshje të sigurisë me kryeministrin e Belgjikës, Alexander De Croo, në Bruksel. Zelensky ka thënë se marrëveshja në vlerë të 977 milionë dollarëve tregon për përkushtimin e Belgjikës për t'i ofruar mbështetje Ukrainës në periudhën 10-vjeçare. Sipas presidentit ukrainas, marrëveshja tregon "për herë të parë" që Ukraina do të pranojë 30 aeroplanë ushtarakë F-16, dhe i pari do të dërgohet më vonë gjatë këtij viti. Kjo marrëveshje e sigurisë është



rezultat i një vendimi të marrë prej krerëve të shteteve anëtare të NATO-s, përgjatë një samiti në kryeqytetin e Lituanisë,

Vilnius, në korrik të vitit të kaluar. Atëherë, vendet anëtare janë pajtuar të nënshkruajnë marrëveshje bilaterale me Ukrainën, për t'ia garantuar sigurinë këtij vendi në periudhë afatgjatë. Marrëveshjet garantojnë që Ukraina do të pranojë armë dhe ndihmë financiare për t'i mbushur zbrastëritat që ka derisa vendi ta jetësojë synimin për anëtarësim në NATO. Marrëveshja vjen teksa Rusia vazhdon të avancojë në fushëbetë në tokën ukrainase. Ushtria ukrainase e ka vuajtur mungesën e armëve dhe

municionit në muajt e fundit, derisa Shtetet e Bashkuara e kanë miratuar ndihmën ushtarake në vlerë të 61 miliardë dollarëve për këtë vend. Lufta në Ukrainë ka nisur më 24 shkurt të vitit 2022. Presidenti rus Vladimir Putin e quan luftën "operacion special ushtarak" për ta çmilitarizuar Ukrainën. Perëndimi është përgjigjur ndaj Rosisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.

Spanja, Irlanda dhe Norvegjia njohin shtetin palestinez

MADRID, 28 MAJ - Spanja dhe Norvegjia e kanë njohur të martën edhe zyrtarisht shtetin palestinez, ndërsa njëjtë do të veprojnë edhe Irlanda më vonë gjatë ditës. Norvegjia e ka konsideruar 28 majin "ditë speciale" - kur është zyrtarizuar njohja e shtetit palestinez. Ministri i Jashtëm norvegjez, Espen Barth Eide, ka thënë përmes një deklarate që "për

më shumë se 30 vjet Norvegjia ka qenë ndër avokueset më të fuqishme për shtetin palestinez. Dita e sotme, kur Norvegjia e njeh zyrtarisht Palestinën shtet, shënon një moment historik në mes të Norvegjisë dhe Palestinës". Kryeministri i Spanjës, Pedro Sanchez, ka thënë në mëngjes se vendi i tij do ta njohë shtetësinë palestineze, duke përfshirë Rripin e Gazës dhe

Bregun Perëndimor me Jerusalemin Lindor si kryeqytetin e tij. Këto tri shtete evropiane besojnë se iniciativa e tyre ka ndikim të madh dhe që do t'i inkurajojë edhe vendet e tjera të veprojnë njëjtë. Ato përmendin edhe rolin historik të Norvegjisë dhe Spanjës në avancimin e përpjekjeve për paqe në mes të izraelitëve dhe palestinezëve.



Dëshmia e diplomatit austriak në Hagë: Nuk dinim për strukturën e UÇK-së më 1998, amerikanët e cilësonin si të shpërndarë

Diplomati austriak Jan Kickert, në dëshminë e tij në Speciale, ka thënë se dinim shumë pak për strukturën e UÇK-së. Kickert, i cili ka punuar diplomat në Beograd, ka thënë se amerikanët u kishin thënë se kjo pjesë ishte misterioze, por që kishin përshtypje se ishte strukturë horizontale dhe e shpërndarë. Po ashtu, ai ka thënë se kishin ndjesinë se zonat e ndryshme të UÇK-së nuk e kishin strukturën e njëjtë. Ai ka thënë se nuk kanë qenë shumë të interesuar për strukturën e UÇK-së në verën e vitit 1998, por interesi i tyre ishte të gjenin dikë që ta përfshinin në proceset politike

HAGË, 28 MAJ - Në Gjykatën Speciale në Hagë ka filluar dëshminë dëshmitari i 68 i Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS), Jan Kickert, i cili mban kodin "W02144" në procesin gjyqësor ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

Në dëshminë e tij, Kickert, i cili ka punuar në Beograd si diplomat austriak, ka thënë se ata dinim shumë pak për strukturën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Ai ka pohuar se amerikanët u kishin thënë se kjo pjesë ishte misterioze, por që kishin përshtypje se ishte strukturë horizontale dhe e shpërndarë. Këtë deklarata, dëshmitari Kickert e ka bërë pasi avokati i Hashim Thaçit, Luka Mishetiç, ia ka paraqitur një kabllogram të 27 qershorit 1998, të cilin vetë dëshmitari e kishte shkruar. "Keni shkruar: Struktura komanduese e UÇK-së ngelet si diçka misterioze sipas Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA). Megjithatë, UÇK-ja vepron duke përdorur emër si shtabi i përgjithshëm e në pamjen e Shteteve të Bashkuara është një strukturë e shpërndarë horizontale dhe struktura koordinimi. Kjo do të ishte problematike për ta përfshirë UÇK-në në politikë. A ju kujtohet nga ku ju ka ardhur ky informacion?", ka pyetur Mishetiç.

Por, dëshmitari ka thënë se kjo gjë ishte thënë në takimin e Grupit të Kontaktit. "Ka ardhur nga amerikanët. Nuk e di kush ishte i pranishëm gjatë takimit. Në qoftë se mund ta shohë titullin e raportit pak më sipër ishte takim i Grupit të Kontaktit të misionëve. Ndoshta ka qenë ambasadori amerikan, zëvendësambasadori që e ka dhënë këtë informatë", ka thënë Kickert. Sipas tij, mund të ketë qenë edhe ndonjë atashe ushtarake, ndërsa ka thënë se vëzhguesit e Bashkimit Evropian (BE) kishin përvoja të ndryshme me anëtarët e UÇK-së në zona të ndryshme. "Ne nuk dinim shumë, pak fare. Përpjekim të kuptonim se si ishte e organizuar dhe strukturuar UÇK-ja. Më kujtohet që vëzhguesit e Bashkimit Evropian kishin

përvoja të ndryshme në pjesët e ndryshme të Kosovës gjatë kontakteve të tyre me UÇK-në. Disa ishin më agresivë, disa trajtonin praninë e vëzhguesve në mënyrë më të qetë", ka thënë ai. Më tutje, Kickert ka theksuar se kishte ndjesinë se zonat e ndryshme të UÇK-së nuk e kishin strukturën e njëjtë. "Në atë kohë ndjenja ime ishte që ishte një qendër në rajonin e Drenicës, por jo që detyrimisht UÇK-ja në pjesën perëndimore të Kosovës, në zonën e Dukagjinit, për shembull, ishte në të njëjtën strukturë apo e centralizuar në të njëjtën strukturë", ka thënë Kickert.

Përpara kësaj, dëshmitari ka thënë se nuk kanë qenë shumë të interesuar për strukturën e UÇK-së në verën e vitit 1998, por interesi i tyre ishte të gjenin dikë që ta përfshinin në proceset politike. Diplomati Kickert ka pohuar se në verën e vitit 1998 është takuar me diplomatin Richard Holbrooke dhe që në njërin prej këtyre takimeve kishte thënë që nuk dihej nëse UÇK-ja kishte ndonjë zinxhir të brendshëm komandues. "Besoj që amerikanët kishin më shumë informacione inteligjencë sesa ne. Amerikanët kishin një prani në Prishtinë. Kishin edhe një shërbim të informacionit të Shteteve të Bashkuara, ndërkohë që ne evropianët nuk kemi pasur prani të vazhdueshme atje. Kështu që, si e kemi kuptuar situatën në atëherë, ishte që prania apo prania e Shteteve të Bashkuara përfshinte edhe pjesën e informacionit inteligjent ose informimit në përgjithësi", ka thënë dëshmitari Kickert.

Absurdi special: Prokurori thotë se Krasniqi gërvishti Rugovën në fotografi për shkak të armiqësisë, mbrojtja e konsideron paragjykim

Gjatë dëshmisë së tij në Hagë, dëshmitari Jan Kickert i është paraqitur një fotografi, në të cilën është thënë se shihej delegacioni i Rambujesë e që ishte gërvishtur



ish-presidenti Ibrahim Rugova. Gërvishtja pretendohet se është bërë nga Jakup Krasniqi. Pasi dëshmitari identifikoi se Rugova ishte i gërvishturi në fotografi, prokurori ka kërkuar që kjo provë të pranohet në prova materiale. Por, duke u përgjigjur në pyetjen e trupit gjyqësor, prokurori John Capin ka thënë se fotografia e dëmtuar dhe e cila është gjetur në shtëpinë e Krasniqit reflekton ndjesinë dhe armiqësisë që ka pasur i akuzuari ndaj Rugovës. Përpara kësaj, pranimin e kësaj fotografie si provë materiale e ka kundërshtuar mbrojtja e Krasniqit përmes avokatit Aiden Ellis.

Ellisi ka thënë se ajo ka efekt paragjyqësor pasi që nuk dihet se në çfarë rrethanash është gjetur në shtëpinë e Krasniqit. Gjithashtu, Ellis ka thënë se kjo fotografi nuk ka asnjë provë se si ka përfunduar në shtëpinë e Krasniqit dhe, sipas tij, rëndësia është shumë e vogël. "Nuk ka asnjë provë që vërtetohet se si ka përfunduar kjo fotografi në shtëpinë e z. Krasniqi dhe mendojmë që rëndësia është

shumë e vogël dhe ka një efekt paragjyqësor të pranohet kjo fotografi pa u vërtetuar", ka thënë ai.

Megjithatë, kryetari i trupit gjyqësor, Charles Smith, ka thënë se kjo fotografi do të pranohet në provat materiale, kurse vlera provuese e saj do të përcaktohet më vonë nga trupi gjyqësor. Personat që identifikoi dëshmitari Kickert në fotografi ishin: Xhavit Haliti, Skender Hyseni, Ibrahim Rugova, Ramë Buja, Blerim Shala, Veton Surroi, Fehmi Agani, Jakup Krasniqi, Hidajet Hyseni...

Përpara kësaj deklarate, dëshmitari ka pohuar se ka kontaktuar me Hashim Thaçin përmes telefonit në vitin 1998 dhe 1999.

Prokurori është fokusuar edhe për një sërë takimesh që kishte pasur dëshmitari me Hashim Thaçin, Kadri Veselin dhe Jakup Krasniqin në korrik të 1998-s për të cilat ka treguar cili ishte qëllimi i tyre si diplomatë.

"Qëllimi ynë ishte të identifikojmë një person të UÇK-së që do të ishte në gjendje

të përfshihet në procesin politik dhe të ishte me autoritet në emër të UÇK-së", ka thënë dëshmitari, duke shtuar se nuk dinim asgjë për UÇK-në se si funksiononte.

Ndërsa për një takim tjetër i cili ishte mbajtur në janar të 1999-s lidhur me lirimin e pesë ushtarëve serbë, dëshmitari ka thënë se ka qenë takim i gjatë. "Ka qenë takim i gjatë sepse mendoj se nuk mund të merrej vendimi menjëherë. Për t'u konsultuar mbase. Përfaqësuesit shqiptarë të Kosovës në atë takim konsultoheshin me të tjerët. Nuk ishte e pazakontë diçka e tillë. Gjatë gjithë angazhimeve që kemi pasur me UÇK-në nuk ka pasur një person që mund ta merrte vendimin vetë. Ne kishim përshtypje se vendimmarrja ishte kolektive", ka thënë ai.

Procesi gjyqësor ndaj liderëve të UÇK-së, Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit, ka filluar në prill të vitit 2023, ndërsa ata janë duke u mbajtur në paraburgim nga nëntori i vitit 2020. /Betimipërdrejtësi

Dëshmitari mohon të ketë dëgjuar për formimin e gjykatës ushtarake në UÇK dhe obligimin e Thaçit për mbikëqyrjen e saj

Dëshmitari i 68 i Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS), diplomati austriak Jan Kickert, ka mohuar se ka dëgjuar për formimin e një gjykate ushtarake në UÇK dhe se shëf i saj të jetë personi i quajtur Sokol Dobruna. Gjithashtu, dëshmitari ka mohuar se e dinte që puna e Hashim Thaçit ka qenë ta mbikëqyrë funksionimin e kësaj gjykate ushtarake.

Ndërsa i pyetur lidhur me përfaqësimin e shqiptarëve në

procesin politik e sidomos gjatë marrëveshjeve që dolën nga ky përfaqësim, dëshmitari ka thënë se LDK-ja nuk kishte qasje miqësore ndaj UÇK-së. "LDK-ja nuk kishte qasje miqësore ndaj UÇK-së. Në fillim madje mohoi edhe ekzistencën e UÇK-së. Ne, po ashtu, kishim FARK-un, grupin e armatosur që financohej nga LDK-ja dhe qeverinë e tyre në ekzil. Pra, kishte përplasje, fërkime politike, por besoj që këto fërkime ishin

edhe në terren", ka thënë ai. Dëshmitari ka shtuar se LDK-ja e shihte UÇK-në si kërcënim të monopolit politik. Gjithashtu, dëshmitari ka thënë se gjatë procesit të marrëveshjes së Rambujesë kishte presion mbi Thaçin pasi komandantët e zonave nuk pajtoheshin me këtë marrëveshje. Krahas kësaj, dëshmitari ka pohuar se Thaçi nuk e kishte autoritetin të nënshkruante në emër të UÇK-së.



Pse s'po e njeh Spanja Kosovën?

Çështja e njohjes së Kosovës nga Spanja doli gjatë diskutimit të takimit të ministrave të jashtëm më 27 maj, në Bruksel, në dritën e vendimit të Spanjës për njohjen e shtetit të Palestinës

PRISHTINË, 28 MAJ - Me synimin për të kontribuar në arritjen e paqes mes izraelitëve dhe palestinezëve, Spanja e ka njohur zyrtarisht shtetin palestinez.

Të njëjtën gjë e bënë Norvegjia dhe Irlanda. Me këtë vendim ata iu bashkuan më shumë se 140 shteteve nga 193 vendet anëtare të OKB-së.

Siç tha të martën kryeministri spanjoll, Pedro Sanchez, "njohja e shtetit të Palestinës nuk është vetëm një çështje e drejtësisë historike, me aspirata legjitime të popullit palestinez, por është gjithashtu një imperativ për ta arritur paqen". "Është e vetmja mënyrë për të realizuar zgjidhjen që ne të gjithë e njohim si e vetmja e mundshme për të arritur të ardhmen e paqes - një shtet palestinez që bashkëjeton përkrah shtetit të Izraelit në paqe dhe siguri", tha Sanchez.

Që nga shpallja e pavarësisë në vitin 1988, mbi 140 shtete e kanë njohur pavarësinë e shtetit

palestinez.

Me këtë lëvizje të qeverisë spanjolle, por edhe me arsyetimin e saj, shtrohet pyetja pse Spanja po heziton ta njohë Kosovën, shtet me shumicë shqiptare që e ka shpallur pavarësinë nga Serbia në vitin 2008, pas luftës dhe bombardimeve të NATO-s ndaj Serbisë në vitin 1999? Derisa më shumë se 110 shtete e kanë njohur shtetësinë e Kosovës, ndër të cilat shumica nga BE-ja, si dhe ShBA-ja, Serbia refuzon ta njohë, së bashku me Rusinë dhe Kinën. Spanja, Greqia, Qiproja, Rumania dhe Sllovakia, po ashtu, ende nuk e kanë bërë një gjë të tillë.

Që nga shpallja e pavarësisë në vitin 2008, mbi 100 shtete e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Qeveria spanjolle nuk iu përgjigj pyetjes së Radios Evropa e Lirë nëse njohja e Kosovës mund ta pasojë njohjen e shtetit palestinez. Megjithatë, çështja e njohjes së Kosovës nga Spanja

doli gjatë diskutimit të takimit të ministrave të jashtëm më 27 maj, në Bruksel, në dritën e vendimit të Spanjës për njohjen e shtetit të Palestinës.

Burimet i thanë Radios Evropa e Lirë se për këtë ka pasur një grindje të hapur ndërmjet palëve nga Gjermania dhe Spanja. Derisa Gjermania ishte "shumë bindëse" për njohjen e Kosovës, "Spanja ishte në mbrojtje, duke argumentuar se Kosova nuk

ishite në agjendë".

Ish-ambasadori i Spanjës në Beograd, Raul Bartolome Molina, gjatë vitit 2023 kishte deklaruar se qëndrimi i vendit të tij është i qartë: Spanja nuk e njeh pavarësinë e Kosovës, ndërsa mbështet tentimet e BE-së për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. "Ky qëndrim nuk ka ndërruar, as nuk do të ndërrojë, dhe të gjithë

aleatët tanë e dinë këtë shumë mirë", kishte thënë Bartolome më 30 qershor, një ditë para se të marrë Spanja udhëheqësinë e Presidencës së Bashkimit Evropian.

Pse nuk e njeh Spanja Kosovën shtet?

Arsyeja kryesore lidhur me këtë besohet të jetë qëndrimi i Spanjës karshi aspiratave të rajonit verilindor të saj, Katalonjës, që të pavarësohet.

Ky rajon ka pasur disa përpjekje të pasuksesshme që të ndahet nga Spanja, ndërsa Madridi zyrtar e ka kundërshtuar ashpër këtë lëvizje. "Qartazi, Spanja nuk dëshiron ta njohë Kosovën, sepse do të duhej të pranonte se provincat e një shteti kanë të drejtë të ndahen... Ata nuk duan t'i japin Katalonjës më shumë municion ose argument për ndarje", thotë për Radion Evropa e Lirë, Eran Fraenkel.

Tani i vendosur në ShBA, Fraenkel kishte jetuar për disa vite në Spanjë ku kishte punuar me Qendrën për Punë të Jashtme të Barcelonës, si ekspert për rajonin e Ballkanit.

Ai ka disa publikime mbi Ballkanin dhe marrëdhëniet e

Dialogu Kosovë - Serbi

Kosova dhe Serbia janë në negociata për normalizimin e marrëdhënieve nga viti 2011. Procesi, i ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian dhe i mbështetur nga Shtetet e Bashkuara, nisi fillimisht për çështje teknike, për të kaluar më pas në nivel politik. Në vitin 2013 palët arritën marrëveshjen e parë të parimeve për normalizimin e marrëdhënieve, e cila u bë e njohur si Marrëveshja e Brukselit.

Shumë prej pikave të saj, përfshirë atë për themelimin e Asociacionit të komunave me

shumicë serbe në Kosovë, mbeten pa u zbatuar.

Dhjetë vjet pas, me propozim të BE-së, palët arritën edhe një marrëveshje tjetër për normalizimin e marrëdhënieve, e cila u bë e njohur si Marrëveshja Bazë ose Marrëveshja e Ohrit.

Pothuajse të gjitha pikat e saj vazhdojnë, po ashtu, të mos respektohen nga palët. Derisa ato akuzojnë njëra-tjetrën për shkelje, BE-ja ua ka bërë të qartë se nga normalizimi i marrëdhënieve mes tyre varet procesi i integritimit evropian.

këtij rajoni me Bashkimin Evropian.

Duke komentuar lëvizjen e fundit të Spanjës për njohjen e shtetit palestinez, Fraenkel thotë se këtë çështje e shih të ndarë nga njohja e mundshme e Kosovës. "Kushtet historike dhe politike në Kosovë dhe Palestinë janë shumë të ndryshme saqë në të vërtetë nuk janë të krahasueshme", thotë ai.

Çfarë rrezikon Spanja nga njohja e Palestinës apo e Kosovës?

Ndonëse thotë se mund t'i japë një lloj shtytje kauzës palestineze, Fraenkel beson se qeveritë e shteteve që e njohin shtetin e Palestinës, "e pranojnë që është në parim (gjest) simbolik". "Vendimi mund të jetë me qëllim të mirë se shtetet duan të njohin të drejtën e palestinezëve për vetëvendosje (shtetësi), për të cilën të gjithë pajtohen në parim. Por, askush nuk mund të pajtohet se si të realizohet kjo në praktikë dhe përderisa ka çështje të pazgjidhura mes Izraelit dhe Palestinës, atëherë çështja operacionale (praktike) për shtetësinë palestineze do të shtyhet në vazhdimësi", thotë ai. Ai beson se ekzistojnë edhe disa pengesa të mëdha në drejtim të zgjidhjes me dy shtete. "Njohja e shtetit palestinez është e varur nga të mospasurit luftë, që fatkeqësisht jam pesimist se mund të ndodhë. Pra, të mos ketë luftë dhe të ketë pajtim palestinez mbi atë se çfarë lloj qeverisjeje duan dhe ku do të jetë ajo", shpjegon tutje Fraenkel.

Tutje, Fraenken beson se njohja e shtetit palestinez, nuk do t'i shkaktojë Spanjës apo shteteve tjera ndonjë pasojë të madhe në pozicionin e tyre në politikën ndërkombëtare. "Edhe nëse krijon disa valë ose ndonjë ndjenjë të keqe në mes të Izraelit dhe shteteve që po e njohin shtetësinë palestineze, unë nuk mendoj që është diçka që nuk mund të tejkalohet", thotë ai.

Ndërkaq, meqenëse Spanja e shih Kosovën si një lëvizje separatiste, sipas Fraenkel, pasojat nga një njohje e mundshme, për Spanjën, janë të menjëhershme. "Katalunasit (vite më parë) dëshironin të mbanin një referendum, për të mbajtur një referendum për të shpallur pavarësinë. Madridi e quajti këtë ilegale. Duke pasur parasysh këtë qëndrim të Spanjës ndaj Katalonjës, si do të ishte e mundur që ata të pranonin një Republikë separatiste", shton Fraenkel.

Në deklarime të mëhershme zyrtare në lidhje njohjen e mundshme të Kosovës, Madridi zyrtar kishte thënë për REL-in se "çështja e territorit të Kosovës të zgjidhet përmes dialogut ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës".

Më 6 janar, megjithatë, Spanja ka njohur pasaportat e Kosovës, duke u mundësuar qytetarëve të Kosovës që të udhëtojnë pa viza edhe në këtë shtet, pas heqjes së regjimit të vizave për kosovarët më 1 janar, 2024.

Por, autoritetet e këtij vendi sqaruan për REL-in se kjo nuk nënkupton njohje të Kosovës. Liderët e Kosovës, megjithatë, në vazhdimësi deklarojnë se presin ndryshim qëndrimi nga shtetet mosnjohëse evropiane.

Çfarë rëndësie ka njohja e shtetit palestinez nga Spanja, Irlanda dhe Norvegjia?

Vendimi i OKB-së i vitit 1948 që krijoi Izraelin, parashikonte një shtet fqinj palestinez, por rreth 70 vjet më vonë kontrolli i territoreve palestineze mbetet i ndarë dhe ofertat për anëtarësim në OKB janë mohuar.

Shtetet e Bashkuara, Britania dhe vende të tjera perëndimore kanë mbështetur idenë e një shteti të pavarur palestinez që ekziston përkrah Izraelit si një zgjidhje për konfliktin më të vështirë të Lindjes së Mesme, por këmbëngulin se shtetësia palestineze duhet të vijë si pjesë e një zgjidhjeje të negociuar.

Negociata thelbësore nuk ka pasur që nga viti 2009.

Megjithëse vendet e BE-së dhe Norvegjia nuk do ta njohin një shtet ekzistues, vetëm mundësinë për një të tillë, simbolika ndihmon në ngritjen e pozitës në nivel ndërkombëtar të palestinezëve dhe shton presionin mbi Izraelin për t'i hapur negociatat për përfundimin e luftës.

Gjithashtu, ky hap i jep rëndësi shtesë çështjes së Lindjes së Mesme përpara zgjedhjeve të qershorit për Parlamentin

Evropian, kur rreth 370 milionë njerëz kanë të drejtë të votojnë teksa një rritje e madhe e së djathtës ekstreme është në skenë.

Presioni diplomatik ndaj Izraelit është rritur teksa beteja me Hamasin - i shpallur grup terrorist nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian - ka hyrë në muajin e saj të tetë. Asambleja e Përgjithshme e OKB-së votoi me një diferencë të konsiderueshme më 11 maj për t'i dhënë "të drejta dhe privilegje" të reja Palestinës në shenjë të mbështetjes në rritje ndërkombëtare për një votim për anëtarësimin.

Udhëheqësit e Spanjës, Irlandës, Maltës dhe Sllovenisë thanë në mars se po e shqyrtonin njohjen e një shteti palestinez si "një kontribut pozitiv" drejt përfundimit të luftës.

Edhe pse dhjetëra vende e kanë njohur Palestinën, asnjë nga fuqitë kryesore perëndimore nuk e ka bërë këtë dhe është i paqartë ndryshimi që mund të sjellë lëvizja e këtyre tri vendeve. Megjithatë, njohja e tyre do të shënonte një arritje të rëndësishme për palestinezët,


të cilët besojnë se kjo i jep legjitimitet ndërkombëtar luftës së tyre.

Pak ka të ngjarë të ndryshojnë gjërat në terren në një afat të shkurtër. Bisedimet për paqe kanë ngecur dhe Qeveria e vijës së ashpër e Izraelit refuzon ta ndryshojë qëndrimin e saj kundër shtetësisë palestineze.

Izraeli reagoi menjëherë më 22 maj, duke tërhequr ambasadorët e tij nga Irlanda dhe Norvegjia.

Qeveria izraelite kritikoi bisedimet për pavarësinë e Palestinës duke i quajtur si një "shpërblim" për sulmin e Hamasit në jug të Izraelit më 7 tetor, i cili vrau 1.200 njerëz dhe rrëmbeu mbi 250 të tjerë. Ajo kundërshton çdo lëvizje për të legjitimuar palestinezët ndërkombëtarisht.

Disa fuqi të mëdha kanë treguar se qëndrimi i tyre mund të jetë duke evoluar mes protestave për pasojat e ofensivës së Izraelit në Gaza, që ka vrarë më shumë se 35.000 palestinezë sipas Ministrisë së Shëndetësisë të Gazës. Ministria nuk bën dallim midis joluftëtarëve dhe luftëtarëve në numërimin e saj.



Raporti i Borrellit për Kosovën mund ta përfshijë edhe mbylljen e bankave në veri

PRISHTINË, 28 MAJ - Zëdhënësi i Bashkimit Evropian, Peter Stano, ka thënë të martën se kryediplomati i Bashkimit Evropian, Josep Borrell, është duke e finalizuar raportin rreth hapave që ka marrë Kosova për heqjen e masave ndëshkuese të bllokut evropian dhe se aty do të përfshihen edhe operacionet e autoriteteve të Kosovës për mbylljen e objekteve të Bankës Kursimore të Postës së Serbisë në veri të Kosovës.

Më 20 maj autoritetet në Kosovë kanë kryer një operacion policor ndaj institucioneve financiare serbe në veri të Kosovës, që ka rezultuar me mbylljen e gjashtë objekteve të Bankës Kursimore të Postës dhe Bankës Popullore të Serbisë në katër komunat në veri të Kosovës, të banuara me shumicë serbe.

Gjatë aksionit, që autoritetet e Kosovës e kanë cilësuar si masë

për vendosjen "e rendit dhe ligjshmërisë", janë konfiskuar prova të ndryshme, përfshirë para.

Vendet anëtare të BE-së kanë kërkuar javë më parë që Borelli ta përpilojë sa më shpejt një raport, për të kuptuar se çfarë ka bërë Kosova për përmbushjen e kushteve për t'ia hequr masat e vendosura.

Shumica e vendeve anëtare kanë propozuar që masat të hiqen tërësisht, ndërsa disa shtete që të hiqen gradualisht. Por, para se të marrin vendim, ato kanë kërkuar edhe vlerësimin e Borrellit.

Radio Evropa e Lirë ka mësuar nga burimet diplomatike se për shkak të zhvillimeve rreth mbylljes së objekteve të Bankës Kursimore të Postës së Serbisë, është kërkuar që këto veprime të merren parasysh në raportin e Borrellit.

Njëjtë ka thënë edhe Stano më 28 maj.



"Masat ishin vendosur si pasojë e veprimeve të pakoordinuara dhe të njëanshme të Kosovës, që sollën deri te përshkallëzimi i situatës. Masat ishin vendosur me qëllim që të motivohen autoritetet e Kosovës për të ndërmarrë hapa për shtensionim. Natyrisht, gjithçka që ka ndikim negativ në

teren, dhe në përpjekjet për shtensionim, është duke u marrë parasysh dhe është duke u marrë përfshirë në raport", ka thënë ai. Edhe Shtetet e Bashkuara, edhe Bashkimi Evropian, kanë thënë se veprimet e fundit të autoriteteve të Kosovës kanë qenë të "njëanshme dhe të

pakoordinuara".

Në bazë të fjalorit që ka përdorur zëdhënësi i BE-së - duke paraqitur qëndrimin e Bashkimit Evropian - diplomatët vlerësojnë se tani do të jetë më vështirë që të propozohet heqja e masave ndaj Kosovës.

Megjithatë, disa vende anëtare janë ende në pritje të raportit.

Bashkimi Evropian ka vënë masa ndëshkuese ndaj Kosovës një vit më parë, me arsyetimin se Kosova nuk ka bërë mjaftueshëm për ta shmangur përshkallëzimin e tensioneve në maj të vitit të kaluar në veri të vendit.

Në atë kohë serbët lokalë kanë protestuar kundër hyrjes së kryetarëve shqiptarë në objektet komunale në Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok.

Në rritje e sipër të tensioneve, serbët lokalë janë konfrontuar me pjesëtarë të misionit të NATO-s në Kosovë, KFOR, duke lënë të plagosur dhjetëra ushtarë.

Sarrazi takon Osmanin dhe Kurtin, temë diskutimi marrëveshjet e dala nga Procesi i Berlinit



PRISHTINË, 28 MAJ - Presidentja Vjosa Osmani ka pritur të martën në takim të dërguarin e posaçëm të Republikës Federale të Gjermanisë për Ballkanin Perëndimor, Manuel Sarrazin.

Në takim është biseduar për zhvillimet e fundit politike dhe të sigurisë në vend dhe rajon. Presidentja Osmani theksoi përkushtimin e Kosovës në procesin e integritetit evropian, duke shprehur mirënjohjen për

mbështetjen e Gjermanisë. Ajo në veçanti theksoi mbështetjen e plotë për Procesin e Berlinit dhe marrëveshjet e dala nga ky proces. Në të njëjtën kohë, presidentja Osmani shtroi nevojën për vazhdimin e mbështetjes gjermane për forcimin e pozitës ndërkombëtare të Kosovës si dhe përmbushjen e aspiratave për anëtarësim në Këshillin e Evropës, NATO, BE dhe organizata të tjera ndërkombëtare.



Edhe kryeministri Albin Kurti ka takuar të martën përfaqësuesin e Posaçëm të Gjermanisë për Ballkanin Perëndimor, Manuel Sarrazin, në Rezidencën e Ambasadorit të Gjermanisë në Kosovë, Jörn Rohde.

Progresi në zbatimin e marrëveshjeve të mobilitetit në Procesin e Berlinit, bashkëpunimi rajonal dhe pritjet nga samiti i radhës që në 10-vjetorin e tij do të mbahet në Berlin, ishin temë e

diskutimit. Kryeministri kujtoi rëndësinë që para samitit të radhës të fillojë zbatimin e marrëveshjes për udhëtim me letërnjoftime ndërmjet Kosovës dhe Bosnjë-Hercegovinës, që lehtëson lëvizjen e lirë të qytetarëve. Kryeministri theksoi se më 16 maj në Kotor të Malit të Zi, Kosova kërkoi që Ballkani Perëndimor të bëhet pjesë e Autoritetit Kundër Pastrimit të Parave (AMLA) të

Bashkimit Evropian për ta rritur integritetin financiar dhe për ta forcuar bashkëpunimin në luftën kundër krimit financiar, kërkesë kjo që u bë pjesë e deklaratës së përbashkët të lëshuar në Kotor.

Për kontributin dhe rolin e tij në forcimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Gjermanisë, si dhe në avancimin e bashkëpunimit rajonal, kryeministri e falënderoi Sarrazin.

"Procesi i Berlinit është platforma ku angazhohemi për bashkëpunim rajonal dhe integritet ekonomik. Tregu i Përbashkët Rajonal i dalë nga Procesi i Berlinit së bashku me Planin e Rritjes janë mundësi për zhvillimin e Ballkanit Perëndimor dhe shpejtimin e reformave për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Republika e Kosovës është proaktive dhe kontribuuese e këtij procesi të rëndësishëm", është theksuar në njoftimin e Qeverisë së Kosovës.

KQZ-ja, fushatë për edukimin dhe informimin e votuesve të rinj: Zëri yt, vota jote!

PRISHTINË, 28 MAJ - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është duke vazhduar fushatën informuese dhe edukuese për të rinjtë të cilët mund të jenë votues për herë të parë në procesin e ardhshëm zgjedhor.


Në ditët e fundit KQZ-ja takoi të rinjtë nga komunat Ferizaj, Skenderaj, Klinë, Deçan, Hani i Elezit dhe Viti,

për t'i informuar lidhur me aspekte të ndryshme për procesin zgjedhor në Republikën e Kosovës.

Kush ka të drejtë vote? Kush garon në zgjedhje? Pse duhet të votosh? Çka është vota? - janë vetëm disa nga pyetjet me përgjigjet e të cilave po informohen të rinjtë gjatë fushatës edukuese dhe informuese:

Vota jote, zëri yt!

Deri më tani ligjëratat dhe takimet e tilla janë mbajtur në komunat: Prishtinë, Prizren, Glogoc, Gjilan, Istog, Fushë-Kosovë, Kamenicë, Mitrovicë, Obiliq, Pejë, Podujevë, Shtime, Novëbërd, Gracanicë, Kaçanik, Vushtrri, Dragash, Rahovec, Shtërpçë dhe Junik.



Rekrutimi i pavarur, i përgjegjshëm dhe profesional, thelbësor për të ardhmen e Kosovës

PRISHTINË, 28 MAJ - Kryeministri Albin Kurti ka pritur të martën në hapësirat e Ballkonit të Hapur ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Jonathan Hargreaves, së bashku me përfaqësues të Ambasadës Britanike në kuadër të projektit “Rekrutimi i pavarur, i përgjegjshëm, meritokratik dhe profesional në Kosovë”.

Në fjalën e tij të rastit, kryeministri Kurti theksoi suksesin e projektit të rekrutimit në Kosovë, teksa shtoi se kanë një rrugë të gjatë përpara për të ndërtuar një sistem rekrutimi bazuar në meritokraci në sektorin publik. Ai shtoi se rekrutimi i pavarur, i përgjegjshëm, i bazuar në meritë dhe profesional, është thelbësor për të ardhmen e Kosovës.

Kryeministri Kurti nënvizoi dhe rëndësinë e eliminimit të hendekut gjinor, e ku 40 % e profesionistëve të emëruar janë gra, duke e vlerësuar këtë si një prioritet të lartë për qeverinë. “Një

nga arritjet më të mëdha që nga viti 2021 është se 40 % e profesionistëve të emëruar janë gra, duke ndihmuar në eliminimin e hendekut gjinor dhe thyerjen e tavanit e xhamit për gratë - një prioritet i lartë ky për qeverinë tonë. Projekti ka gjeneruar metoda të shumta për të kultivuar një kulturë respekti për aftësinë dhe ekselencën brenda institucioneve tona. Një shembull kryesor është ‘Harta e Procesit’, një manual gjithëpërfshirës që përshkruan praktikën më të mira të rekrutimit në përputhje me ligjet dhe rregulloret tona”, tha kryeministri Kurti.

Në fund, ai i falënderoi përfaqësuesit e projektit dhe Ambasadën e Britanisë për kontributin e përkrahjen e tyre si dhe bëri thirrje për më shumë transparencë, përgjegjshmëri dhe meritokraci në procese të ngjashme, për një të ardhme më të ndritur për Kosovën.



Jasharaj: Qeveria Kurti po zhvillon luftë të vazhdueshme për t'i shuar sindikatat

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 28 MAJ - Kryetar i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK), Rrahman Jasharaj, ka thënë se qeveria në emër të dialogut të jashtëm është duke e ngulfatur dialogun e brendshëm. “Nuk është e imja të bëj analizë të dialogut të jashtëm të qeverisë e as të veprimeve të saj në veri, por këto po i përmend për të theksuar se Kurti dhe qeveria e tij në emër të dialogut të jashtëm dhe veprimeve dhe gjendjes në veri ka ngulfatur dialogun e brendshëm dhe ka zhvilluar luftë të vazhdueshme për t'i shuar sindikatat dhe këtë detyrë e ka marrë nga Kurti ministri Murati. Ky ministër i urren sindikatat dhe bëri çmos që t'i shuajë ato me përpjekjet fillestare bashkë me Kurtin që të krijojnë tronditje brenda sindikatave dhe të sjellin udhëheqës sindikalë që janë njerëz të tyre. Po ta kishin arritur



këtë, atëherë qeveria do të zhvillonte përditë takime me ta,

do të fotografoheshin dhe ata udhëheqësit sindikalë të shitur

do të ngrehnin në qiell qeverinë duke gënjer për të. Qeveria Kurti dështoi në këtë përpjekje, prandaj SBASHK-u dhe disa nga sindikatat e tjera u janë bërë halë në sy dhe nuk pushuan luftën kundër tyre”, është thënë në deklaratën e Jasharaj.

Ai ka shtuar se ministri Murati kishte shpresë se me platformën e-Kosova do t'i gjuhëzonte sindikatat duke menduar se anëtarësia do të hezitonte të regjistrohej pasi, sipas tij, edhe procedurat janë të koklavitura. “Duhet pranuar se me këtë veprim, të vetmin në Evropën demokratike, ai arriti të godasë rëndë disa nga sindikatat sepse anëtarësia e tyre në numër të vogël është regjistruar në këtë platformën e Hekuranit dhe në mungesë mjete, ato vështirë se mund të funksionojnë dhe rrezikojnë të shuhen. Hekurani syrin e kishte të SBASHK-u për ta shuar, por i shkoi plani huq sepse në këtë platformë u regjistruan mijëra anëtarë e po vazhdojnë të regjistrohen sepse ata kanë

besim të plotë në sindikatën e tyre. Hekurani duke e parë këtë realitet u inatos dhe bëri tash një veprim tjetër. Qindra anëtarëve të regjistruar nuk ua ndal kuotën sindikale. Kjo është goditje e radhës e tij, por pa rezultate”, ka theksuar Jasharaj.


Ai ka thënë se ministri Murati në vend të këtyre goditjeve duhet ta kryejë detyrën e tij e të mos e ngufasë dialogun e brendshëm, por ta riaktivizojë Këshillin Ekonomik Social dhe përmes tij edhe të krijohen kushtet që të nënshkruhet Marrëveshja Kolektive, e cila vetëm në Kosovë, krahasuar me vendet e Ballkanit e Evropës, mungon. “Kryeministri Kurti dhe ministri Murati duhet të pajtohen se këto janë sindikatat në Kosovë dhe këta janë udhëheqësit e tyre që janë zgjedhur me votën e anëtarësisë dhe se vetëm kjo votë mund t'i shkarkojë ata dhe të nisë me dialogun e sinqertë me ta duke shqyrtuar kërkesat e anëtarësisë e duke i zgjedhur e realizuar ato”, ka thënë Jasharaj.

Lansohet në e-Kosova paraqitja online e provimit të maturës

PRISHTINË, 28 MAJ - Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) ka njoftuar se është lansuar në platformën e-Kosova paraqitja online e Provimit të Maturës Shtetërore. Sipas MASHTI-t, paraqitja online e provimit ka për qëllim ta lehtësojë punën e të gjithë maturantëve,

shkollave, komunave dhe MASHTI-t në këtë proces. “Përveç paraqitjes online të Provimit Shtetëror të Maturës, kjo platformë do të mundësojë edhe gjenerimin e të dhënave për orientimin dhe sistemimin e maturantëve në qendrat e testimit, shpalljen e rezultateve dhe përgatitjen e certifikatës së maturës online.

Procesi i aplikimit për maturantët në platformën e e-Kosova do të jetë shumë i lehtë, i shpejt dhe efektiv në procesimin e të dhënave dhe adresimin e informatave”, thuhet në njoftim. Më tej, ministria ka shpjeguar edhe procedurat e procesit të aplikimit për maturantë në platformën e-Kosova.



Skema e re sociale, tri fazat që duhet t'i kalojë një familje për ta përfituar ndihmën financiare nga shteti

PRISHTINË, 28 MAJ - Nga data 18 maj qytetarët mund të aplikojnë për t'u përfshirë në skemën e re të asistencës sociale përmes platformës e-Kosova.

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët mbi moshën 18 vjeç, ndërkaq pas kësaj aplikimi kalon në tri faza. Elvira Berisha, eksperte e Komunikimit për Projektin e Reformës së Sistemit të Asistencës Sociale të Kosovës, në një intervistë për "Telegraf"-in, ka sqaruar më hollësisht se si bëhet aplikimi e deri te përfitimi i kësaj asistence sociale. "Për reformën, pilotimin e reformës së asistencës sociale mund të aplikojnë të gjithë ata që janë banorë dhe shtetas të Republikës së Kosovës. Pra, aplikimi është në baza familjare. Mjafton një person i rritur mbi tetëmbëdhjetë vjeç brenda familjes që të aplikojë për të gjithë familjen", ka deklaruar ajo. Më tej, Berisha tregoi se aplikimi do të kalojë në tri faza, derisa theksoi se aplikimi do të jetë i hapur gjatë gjithë vitit kalendarik. "Do të bëhet testimi i varfërisë. Pra, do të bëhet në tri faza të rëndësishme: fillimisht është testimi i parë që quhet verifikimi i mjeteve financiare, dhe për



kualifikim duhet të rezultojë që kur të logariten të gjitha të hyrat e llogaritshme siç janë nga punësimi, apo qiraja, apo të ngjashme, duhet të rezultojë që familja merr më pak se 100 euro për anëtar për muaj", potencoi ajo.

Në fazën e dytë Berisha pohoi se do të bëhet verifikimi i pasurisë që ka familja që ka aplikuar. "Tutje është testi i dytë i aseteve apo pasurisë, i cili kur të bëhet verifikimi i pasurisë së asaj

familje, për t'u kualifikuar tutje duhet të rezultojë që familja nuk ka prona apo patundshmëri mbi vlerën njëqind mijë euro. Ndërsa nëse kalohen pra këto dy teste, atëherë është testimi i tretë apo verifikimi që quhet testi i mjeteve të përafërta, që verifikon mirëqenien e përgjithshme të familjes, kushtet e jetesës, kushtet e banimit. Qysh jeton ajo familje? Sa dhoma i ka? Sa shtëpi ka në pronësi? A ka vetura në pronësi? A ka kyçe në ujësjellës,

në internet? Sa telefona celularë e të ngjashme", nënvizoi ajo.

Ekspertja e Komunikimit për Projektin e Reformës së Sistemit të Asistencës Sociale të Kosovës deklaroi se pasi të kalohen tri fazat, familjet do të vizitohen nga ekipet e qendrave për punë sociale. "Pas të gjitha këtyre, pra për familjet e parakualifikuara tutje, do të vizitohen nga qendrat për punë nga ekipet e qendrave për punë sociale në mënyrë që të verifikohen të dhënat dhe të

vazhdohet tutje me vlerësimin e komisionit të përcaktuar nga ministri", shtoi Berisha.

Projekti i Reformës së Sistemit të Asistencës Sociale të Kosovës zbatohet nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve bazuar në Marrëveshjen Financiare me Bankën Botërore.

Skema e re e dizajnuar bazohet në 'test të varfërisë' dhe ka për qëllim të sigurojë barazi për të gjithë, duke arritur te familjet më të cenueshme apo më varfëri dhe ka për qëllim të sigurojë barazi për të gjithë.

Nga Ministria e Financave, Punës dhe Mirëqenies Sociale kanë deklaruar se qëllimi kryesor i skemës është ta heqë diskriminim që ekziston në skemën aktuale.

Me skemën aktuale, në momentin që një fëmijë ka mbushur moshën pesë vjeç, i është ndërprerë përfitimi nga skema sociale, ndërsa tani këto diskriminime janë larguar. Qytetarët që nuk mund të aplikojnë online për asistencë sociale mund të kërkojnë ndihmë nga punëtorët e qendrave sociale në vendin ku ata jetojnë.

ZKA-ja: Katër ndërmarrje publike dhe RTK-ja vazhdojnë të kenë mangësi në fushën e raportimit financiar

PRISHTINË, 28 MAJ - Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka publikuar raportet e auditimit për Radio Televizionin e Kosovës dhe katër ndërmarrje publike: Ndërmarrja Publike Banesore, Ndërmarrja Publike Hidroekonomike "Ibër - Lepenc", Hekurudhat e Kosovës - "Infrakos", si dhe Kompania Rajonale e Mbeturinave "Uniteti". Rezultatet e auditimit tregojnë se këto institucione publike kanë mangësi të theksuara në fushën e raportimit financiar dhe në kuadrin e pajtueshmërisë ligjore. Për shkak të dobësive të identifikuara në raportin financiar për vitin 2023, katër prej tyre kanë opinion auditimi të modifikuar dhe një të pamodifikuar.

Bazuar në gjetjet e auditimit, ZKA-ja ka dhënë opinion të kundërt për Kompaninë Rajonale të Mbeturinave "Uniteti" si dhe konkluzion të kualifikuar të pajtueshmërisë. Ndërsa Radio Televizionit të Kosovës i është kualifikuar edhe opinionin i auditimit dhe konkluzioni i pajtueshmërisë. Kurse Ndërmarrja Publike Hidroekonomike "Ibër - Lepenc" e ka të kualifikuar opinionin e auditimit dhe të pamodifikuar konkluzionin e pajtueshmërisë.

Edhe ndërmarrja Hekurudhat e Kosovës - "Infrakos" e ka të kualifikuar opinionin e auditimit dhe të pamodifikuar konkluzionin e pajtueshmërisë. Ndërsa Ndërmarrja Publike Banesore e ka të pamodifikuar opinionin e auditimit, kurse konkluzionin e pajtueshmërisë e ka të kualifikuar.

Procesi i auditimit në këto institucione ka evidentuar mangësi të Sistemi Informativ i Kontabilitetit dhe në shënime shpjeguese si dhe dobësi tek të hyrat operative. Ndërsa të logaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme është hasur në mbivlerësim të llogarive të arkëtueshme, mos-harmonizim në mes të shënimeve kontabël të llogarive të arkëtueshme dhe letër-konfirmimeve, prezantim i llogarive të arkëtueshme të paidentifikuara, mbivlerësim i detyrimeve tatimore ndaj ATK-së, si dhe detyrimeve të tjera afatshkurtra, mosprezantim i saktë i obligimeve në regjistrin e kompanisë, nënvlerësim i detyrimeve dhe të hyrave nga grantet si dhe mungesë e të dhënave të plota për grantet.

Edhe proceset e prokurimit dhe proceset e rekrutimit janë



përcjellë me dobësi. Gjithashtu, janë identifikuar mangësi të tjera në sistemin e kontrollit të brendshëm të shpalosura në raportet individuale të auditimit. Me qëllim të përmirësimit të qeverisjes, këtë vit ZKA-ja ka dhënë 33 rekomandime si: për Kompaninë Rajonale të Mbeturinave "Uniteti" janë dhënë dhjetë rekomandime, për

Ndërmarrjen Publike Banesore tetë, për Radio Televizionin e Kosovës shtatë, për Ndërmarrjen Publike Hidroekonomike "Ibër - Lepenc" katër si dhe për ndërmarrjen Hekurudhat e Kosovës - "Infrakos" janë dhënë katër rekomandime.

Pavarësisht prej mangësive të identifikuara, krahasuar me vitin paraprak, këto institucione kanë

shënuar përparim sa i përket zbatimit të rekomandimeve. Përderisa për vitin 2022 kanë qenë 63 rekomandime, këtë vit kemi zvogëlim të numrit të tyre për 30 sosh. Kjo tregon se gjatë vitit 2023 ka pasur një përmirësim të menaxhimit financiar dhe kontrollit si rezultat i veprimeve korrigjuese që janë ndërmarrë nga këto institucione.

Deputeti Reçica realizon vizitë të suksesshme në Finlandë



EPOKA ERE **Faton DËRMAKU**

Prishtinë, 28 maj - Deputeti i Kuvendit të Kosovës, njëherësh udhëheqës i Departamentit për Diasporë në Partinë Demokratike të Kosovës, Elmi Reçica, po qëndron për vizitë në Finlandë. Në kuadër të kësaj vizite ai ka takuar bashkatdhetarë në këtë vend, anëtarë të PDK-së dhe përfaqësues të Finlandës, të cilët

përbashkëta të qytetit me ekspertët tanë, bashkëpunimin e bizneseve, shërbimet kulturore, si dhe integrimin dhe mundësitë e bashkëpunimit të mëtutjeshëm në të mirë të shqiptarëve që jetojnë në këtë vend dhe të qytetit të Porvos”, ka shkruar Reçica në “Facebook”.

Ai ka takuar edhe intelektualë shumë të vyer, përkras të PDK-së në Vanta të Finlandës. “Ju falënderoj për pritjen e ngrohtë, si

shfaqën në ekspozitën ‘Jehona e qëndrueshmërisë’ të Haki Xhaklit, në galerinë Luckan, në Helsinki të Finlandës. Për krijimtarinë e tij, dr. Haki Xhakli është frymëzuar nga historia e lashtë dhe moderne e popullit tonë. Suksese, miku im!”, ka shkruar deputeti Reçica.

Mbahet Kuvendi Zgjedhor i Nëndegës së PDK-së në Turku të Finlandës

Deputeti Reçica mori pjesë edhe në Kuvendin Zgjedhor të Nëndegës së PDK-së në Turku të Finlandës, ku kryetar u zgjodh Sadri Selimi dhe, po ashtu, u zgjodh kryesia prej 13 anëtarëve. “Puna dhe angazhimi i pandalshëm për shtrirjen e PDK-së në mërgatë dëshmon përkushtimin e partisë për t’i ruajtur lidhjet me mërgatën dhe për t’i angazhuar aktivisht anëtarët e saj kudo që ndodhen në përfaqësimin sa më dinjitoz në jetën politike të Kosovës”, ka thënë Reçica.

Themelohet Këshilli për Organizimin e Kuvendit të PDK-së për Finlandë

Udhëheqësi i Departamentit për Diasporë në Partinë Demokratike të Kosovës, Elmi Reçica, ka marrë pjesë edhe në themelimin e Këshillit për

inovacionit dhe ideator i shumë platformave të suksesshme. Kushtrimi, me shumë energji dhe pozitivitet, më priti në ekspozitën e babait të tij në Helsinki të Finlandës. Kënaqësi bisedat me të”, ka shkruar Reçica në “Facebook”.

Mirëmëngjesi me profilin e një shqiptari të suksesshëm në Finlandë

Reçica në kuadër të vizitës së tij në Finlandë është takuar edhe me Sadri Beqirin, asamblist në Turku. “Sadri Beqiri është asamblist në



Reçica takon Kushtrim Xhaklin, promovues i inovacionit dhe ideator i shumë platformave të suksesshme

“I lumtur dhe shpirtin plot kur shoh brezat e rinj që po shkruajnë historitë e suksesit në Kosovë dhe kudo në botë. I tillë është Kushtrim Xhakli - profesionist i dalluar nga mërgata jonë, promovues i

Turku dhe është pjesë e partisë së kryeministrit të Finlandës. Sadriu është inspektor i ndërtimeve në njësinë e Shërbimeve të Mjedisit Urban. Takimi me njerëz punëtorë dhe atdhetarë për mua është nder i veçantë. I lumtur kur shoh shqiptarë të tillë si Sadriu që kanë lënë gjurmë pune në vendet ku po jetojnë dhe ende duan të kontribuojnë për Kosovën tonë”, ka shkruar Reçica në “Facebook”.



kanë dhënë kontribut në shtetndërtimin e Kosovës. “Gjatë vizitës sime në Finlandë pata kënaqësinë ta takoj kryetarin e Porvoo, Fredrick von Schoultz, drejtoreshën e Kulturës, Minna Särela dhe drejtoreshën për integrim, Jenny Broberg. I falënderova nga zemra për mbështetjen e Kosovës dhe të mërgimtarëve tanë dhe bashkë biseduam për projektet e

gjithmonë!”, ka shkruar Reçica në “Facebook”.

Reçica viziton ekspozitën ‘Jehona e qëndrueshmërisë’ të Haki Xhaklit

“Sfidat, vuajtjet, qëndresa e krenaria e popullit shqiptar - të gjitha bashkë e të shoqëruara me një botë magjike ngjyrash u



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Cikalleshi pensionohet nga Kombëtarja

TIRANË, 28 MAJ - Sokol Cikalleshi, një ditë pasi që nuk u përfshi në listën e Sylvinhos për "Euro 2024", ka marrë vendim që të tërhiqet nga Kombëtarja e Shqipërisë. Në "Instagram" sulmuesi 33-vjeçar ka bërë me dije se nuk do të jetë më pjesë e

kuqezinjve, duke u shprehur krenar që e përfaqësoi shtetin shqiptar në nivelet më të larta të futbollit. "Ka qenë një krenari dhe emocion i papërshkrueshëm përfaqësimi i fanellës së ekipit kombëtar të futbollit. Bartja e emocioneve të një kombi mbi shpinë është

sa privilegj, po aq edhe përgjegjësi, e cila më ka bërë të përunjur dhe mirënjohës ndaj çdokujt. Ndihej i lumtur përgjatë këtij rrugëtimi. Dhashë pikën e fundit të djersës dhe shpirtin për të bërë më të mirën e mundshme", ka shkruar Cikalleshi në

"Instagram". Sokol Cikalleshi ka 59 paraqitje me fanellën e Shqipërisë, ndërsa në 13 raste ka gjetur edhe rrugën e golit. Aktualisht Cikalleshi është pjesë e Konyasporit në Turqi, ku ka shënuar 12 gola e ka dhuruar 5 asistime në të gjitha garat.



Çeku: MKRS ka dyshime se po keqpërdoret Ligji i Sponsorizimit

PRISHTINË, 28 MAJ - Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka gjetur një numër të konsiderueshëm të shkeljeve në financimin e federatave sportive nga ana e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, sidomos nga procesi i përfitimit nga Ligji i Sponsorizimit si dhe mbështetja financiare e federatave sportive në mënyrë të drejtpërdrejtë nga MKRS. Duke shpalosur të dhënat nga raporti, anëtarja e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, Mirlinda Tishukaj-Sadiku, tha se Zyra e Auditimit ka konstatuar se nga lëshimet në këto dy procese, buxheti i shtetit është dëmtuar me mbi 1.5 milion euro. "Nga mostrat të cilat i ka analizuar Zyra Kombëtare e Auditimit rezultoi se në ATK janë vërejtur se rreth 1 milion e 573 mijë e 246 mijë euro është dëmtuar buxheti i shtetit. Në këtë vlerë hyjnë 490 mijë e 347 euro që janë liruar bizneset nga tatimi dhe këto fonde nuk janë transferuar në klube, ndërsa rreth 1 milion e 83

mijë e 246 euro bizneset i kanë sponsorizuar klubet pa u pajisur me vërtetim nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit... Federatat sportive në Kosovë, nga 2020 deri më 25 tetor 2022, nuk kanë qenë të licencuara. Ato kanë filluar të licencohen me radhë nga data 25 tetor 2022. Edhe pse federatat nuk kanë qenë të licencuara dhe nuk kanë pasur të drejtë të zhvillojnë aktivitete sportive dhe të financohen nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit apo sponsorizimit, Ministria e Kulturës i ka financuar këto federata edhe gjatë kësaj periudhe kohore. Bazë me këtë financim është marrë vendimi i ministrit i datës 30 prill 2021 për vazhdimin e vlefshmërisë së licencave të federatave sportive", ka thënë Tishukaj-Sadiku. Me këto të gjetura është pajtuar edhe vetë ministri i Ministrisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Hajrulla Çeku. Ai ka thënë para komisionit se edhe nga vetë ana



e ministrisë që ai e drejton është nisur një proces tashmë që ka për synim hetimin e disa dyshimeve për keqpërdorim të Ligjit të Sponsorizimit dhe se tashmë me këtë çështje po merret Policia e Kosovës. Ndërsa për financimin e federatave, Çeku tha se kjo po bëhet në bazë procesit për kategorizimin e federatave. "Nga raporti ynë i brendshëm për sponsorizime për vitin 2022, nga lista e përfituesve të sponsorizimit, ne i kemi identifikuar, por ka qenë më tepër një listë e dyshimeve

që i kemi pasur mbi shumatat e sponsorizimit, kemi kontaktuar me Departamentin e Krimeve Ekonomike të Policisë së Kosovës dhe ato shqetësime tona të cilat kanë qenë shqetësime edhe të komunitetit që kanë ardhur te ne i kemi bartur në Policinë e Kosovës dhe kemi kërkuar të zhvillojnë hetime në lidhje me këto dyshime të bazuara, sipas mendimit tim. Kur është fjala për financimin e federatave, natyrisht legjislativi ynë i sportit e parasheh procesin e

kategorizimit të federatave dhe ky proces i kategorizimit në fund, pas vlerësimeve që bëhen nga komisionet profesionale, nxjerrë listën e pikëve për secilën federatë që është minimal i nevojshëm për financimin e federatave", tha Çeku.

Ndërsa drejtori i ATK-së, Ilir Myrtezaj, deklaroi se tashmë ka disa raste kur kompanitë janë detyruar t'i kthejnë paratë që nuk i kanë paguar si tatim duke u mbuluar me Ligjin e Sponsorizimit. "Aty ku nuk janë përmbushur të gjitha kriteret që kërkohen me ligj të sponsorizimit, me ligj të TAK-ut dhe me rregullore, normalisht që i kemi detyruar kompanitë t'i kthejnë mjetet, ta paguajnë tatimin që nuk e kanë paguar duke e justifikuar me gjoja dhënien e sponsorizimeve. Jo vetëm dy, por në të gjitha rastet janë kthyer mjetet. Në të gjitha rastet ku është konstatuar, e që shuma është mbi 1 milion euro", theksoi Myrtezaj.

Inkuadrimi në Superligë dhe gjysmëfinalja e Kupës, Suhareka falënderon Thaqin



SUHAREKË, 28 MAJ - Skuadra e Suharekës e ka falënderuar trajnerin e deritanishëm Arsim Thaqi për punën dhe sukseset e arritura deri tash, me rastin e inkuadrimit në Superligën e Kosovës si dhe kualifikimin deri në gjysmëfinale të Kupës së Kosovës. "Pas marrjes së drejtimit të skuadrës trajneri

Arsim punoi me plan profesional. Nga 19 ndeshje sa ishte në krye të skuadrës me 12 fitore 2 barazime e 5 humbje, arriti që me shumë sukses ta inkuadrojë skuadrën në Superligë. Pas mbylljes së edicionit, takimi me kryesinë e trajnerin nuk arriti deri te marrëveshja për vazhdimin e

kontratës. Kryesia e klubit, stafi i trajnerëve, stafi përcjellës e të gjithë futbollistët e falënderojmë trajnerin Arsim Thaqin për punën e tij e kohën e kaluar sa ishte pjesë e jona duke i uruar gjitha të mirat në jetë e shumë suksese në vazhdim", thuhet në njoftimin e skuadrës së Suharekës.

Kënga e tij do ta shoqërojë Shqipërinë në Evropian, Capital T: Krenari dhe privilegj

TIRANË, 28 MAJ - Kënga e Capital T, e quajtur "Albania", do ta shoqërojë Shqipërinë gjatë rrugëtimit në Evropian. Këngëtari, nëpërmjet një video të postuar nga FShF-ja, e cilëson besimin e dhënë si një krenari

dhe privilegj për të. "Përsëritet gjithë! Uroj të jeni mirë! Jemi këtu për ta prezantuar projektin e ri për ekipin kuqezinj dhe gjithë tifozët anembanë botës. Përfaqësuesve tonë u urojmë shumë suksese! Urojmë të

shkojnë lart e më lart. Shpresoj që kjo këngë do t'i motivojë ata për suksese më të mëdha, por edhe tifozët anembanë botës të festojnë. Po ashtu, ta promovojmë Shqipërinë në sytë e botës siç i ka hije. Është krenari

dhe privilegj i madh, gjithashtu përgjegjësi i madh. Uroj t'ia kemi dalë dhe inshallah ju pëlqen. Mos harroj të cek që jemi të gjithë për një qëllim dhe shumë dashuri për të gjithë", ka thënë Capital T.



Bostoni shpallet kampion në Lindje

Indianapolis, 28 maj - Ekipi i Boston Celticsit shpallet kampion në Konferencën e Lindjes në NBA pas fitores me rezultat 105-102 ndaj Indianas në finalen e katërt të "play-off"-it. Një kosh i Derrick White, 46 sekonda nga fundi i kohës së rregullt, i dha

suksesin Bostonit, që fitoi 4-0 me ndeshje. Sfida e fundit u komandua nga Indiana në shumicën e kohës, që kërkonte fitoren para publikut të vet. Nembhard realizoi 24 pikë e 10 asistime për vendasit, por që nuk mjaftuan për të fituar dhe rihapur

serinë. Për Bostonin u dalluan Jaylen Brown me 29 pikë e Jayson Tatum me 26 pikë e 13 rebounde. Browni u shpall edhe MVP i finaleve në Konferencën e Lindjes, një vlerësim i merituar për të. Bostoni rikthehet në finalen për titull në NBA pas dy vitesh

dhe pret ta mësojë emrin e ekipit rival që do të vijë nga Konferenca e Perëndimit, ku Dallasi udhëheq 3-0 ndaj Minnesotas. Më 6 qershor do të luhet finalja e parë "play-off" në fushën e Bostonit, që ka rezultatin më të mirë në sezonin e rregullt.



Policia gjermane bëhet gati për 'Euro 2024', masa ekstreme për tifozët gjermanë

MUNCHEN, 28 MAJ - Policia gjermane pritet të aktivizojë një plan sigurie me 5 pika për mbarëvajtjen e kompeticionit më të rëndësishëm evropian të futbollit që pritet të nisë muajin e ardhshëm. Evropiani i futbollit do të nisë në Munich më 14 qershor, me ndeshjen e parë që do të vendosë përballë mikpritësit e Gjermanisë me Skocinë, në stadiumin "Allianz Arena". Sipas organizatorëve, më shumë se 2.7 milionë fansa do t'i ndjekin ndeshjet në stadium, teksa 12 milionë të tjerë do të jenë të grumbulluar në sheshet kryesore të 10 qyteteve ku janë parashikuar të luhet takimet e Evropianit. Për këtë arsye, edhe policia gjermane po kryen përgatitjet e fundit për të qenë e gatshme në situatat e ndryshme që mund të krijohen, huliganët e dhunshëm, hajdutët, kriminelët, emigrantët e paligjshëm apo edhe terroristët. Më shumë se 22 mijë efektive të policisë do të vendosen në kufij,



stadiume, Fan Zone, aeroporte, stacione trenash dhe zona të tjera me njerëz çdo ditë. "Bild" raporton se forcat e rendit janë veçanërisht të shqetësuara për rrezikun e huliganëve gjatë Kampionatit Evropian. Në mars, "Mail Sport" raportoi se mijëra tifozëve të futbollit u është ndaluar ta ndjekin Anglinë në Gjermani nën një masë të qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar. Mbi 1 600 tifozë me

urdhra ndalimi do të detyrohen t'i dorëzojnë pasaportat e tyre në polici nga 4 qershori deri në finalen e Kampionatit Evropian më 14 korrik, për t'u siguruar që nuk do të tentojnë t'i ndjekin ndeshjet. Kushdo që nuk dorëzon pasaportën e tij ose tenton të udhëtojë në Gjermani do të përballet me një gjobë të madhe ose burgim, me një dënim maksimal prej gjashtë muajsh.

Nadali eliminohet në start nga Roland Garrosi

PARIS, 28 MAJ - Aventura e tenistit spanjoll Rafael Nadal në grand slam të Roland Garros është mbyllur që në raundin e parë. Fituesi 14 herë i këtij turneu, Nadal, u mund 3-0 (6-3, 7-6, 6-3) nga gjermani Alexander Zverev. Një lamtumirë e hidhur për spanjollin, që ndoshta luajti për herë të fundit në turneun e tij të preferuar. "Nuk e di nëse do të jem sërish këtu vitin tjetër. Nuk dua të bëj asnjë parashikim. Ndoshta rikthehem dhe ju përshëndes sërish. Gjithsesi, për momentin do të fokusohem tek Olimpiada dhe më pas do të vendos. Dy muajt e ardhshëm do të jenë të rëndësishëm për të ardhmen time", ka thënë Nadali. Ndërkohë, fansat e shumtë e kanë duartrokitur gjatë Rafael Nadalit në kohën që bëhej gati për ta lënë fushën. Për ta ai mbetet idhulli i



preferuar, ndaj shpresojnë ta shohin sërish në fushat e Parisit. Spanjollin doli nga fusha me lot në sy, pasi duket se karriera është pranë fundit. Në ndeshjet e tjera të turit të parë spikatin fitoret e Iga Swiatek, Cori Gauff, Daniele

Collins dhe Ons Jabuer te femrat, por u eliminua Maria Sakkari. Te meshkujt, avancojnë në raundin e dytë Jannik Sinner, Stefanos Tsitsipas, Daniil Medvedev, Tommy Paul dhe Kharen Khachanov.

SHKURT

Kroos: Ne e dimë si fitohet Liga e Kampionëve

Finalja e Ligës së Kampionëve do të jetë ndeshje e fundit për Toni Kroosin me fanellën e Real Madridit. Mesfushori gjerman do të pensionohet nga futbollit pas Kampionatit Evropian. Kroos ka thënë se ndeshja ndaj Betisit në "Santiago Bernabeu" ishte e paharrueshme për të ku u përshëndet me tifozët madrilënë. "Jam shumë mirë. Ishte një natë e paharrueshme për mua dhe për të gjithë familjen time. Nuk e prisja gjithë këtë përkëdhelje, por shfrytëzoza të gjitha këto momente të veçanta nga tifozët dhe ekipi. Nuk mund të kërkoja më shumë", ka deklaruar mesfushori gjerman. Megjithatë, ai ka thënë se në finalen e "Wembley" dinë se si ta fitojnë, edhe pse e pranon se do të jetë shumë e vështirë. "Fitorja do të ishte e rëndësishme, jo aq për rekord, por unë do të isha me fat nëse do ta fitoja sërish këtë trofe. E dimë se do të jetë e vështirë, por dimë si t'i fitojmë këto ndeshje dhe shpresojmë të jemi në gjendje ta dëshmojmë këtë në fushë", ka deklaruar Kroosi.

Edersoni, afër largimit nga City

Edersoni mund të largohet nga Manchester City. Sipas raportimeve të medieve britanike, sauditët e Al-Ittihad i kanë drejtuar sytë te lojtari brazilian për sezonin e ardhshëm, me gjigantët e Saudi Pro League, që janë të gatshëm të ofrojnë 25 milionë paundë për të nënshkruar me portierin, ndaj mund të ketë disa zhvillime të rëndësishme në merkaton e verës. Edersoni nga viti 2017 është pjesë e Premierligës, kurse kontribuoi në fitimin e gjashtë kampionateve, katër Kupave të Ligës, dy Kupave FA, dy Community Shields, si dhe në triumfin në Ligën e Kampionëve, Superkupën e Evropës dhe Botës për Klube.

Ronaldo vendos rekord në Arabinë Saudite

Al Nassri mbylli sezonin në Saudi Pro League me një fitore 4-2 ndaj Al-Ittihadit, sfidë në të cilën Cristiano Ronaldo realizoi dy gola dhe jo vetëm. Portugezi vendosi një rekord të veçantë sa i përket kampionatit saudit, pasi Ronaldo bëhet i pari lojtar që realizon 35 gola në një sezon të vetëm. 39-vjeçari arriti këtë kuotë në 31 takime duke e bërë edhe më të bukur këtë rekord, me Ronaldon që e ka kthyer në specialitet thyerjen e tyre. Ish-sulmuesi i Real Madridit u shpall golshënuesi i edicionit duke lënë pas Mitroviçin (Al-Hilal) me 28 finalizime.

Edhe Casemiro pritet të largohet nga Unitedi

Manchester Unitedi e mbylli me trofe edicionin e sivjetmë, duke e fituar FA Cup përballë Manchester Cityt. E tash, Unitedi ka filluar të mendojë për edicionin e ardhshëm. Pak ditë më parë u mësua se Raphael Varane do të largohet si futbollist i lirë. I radhës që pritet ta ndjekë rrugën e tij është Casemiro. Ylli brazilian nuk është në planet e "Djave të Kuq" pasi ka vuajtur edhe nga disa lëndime dhe drejtuesit e klubit duan shitjen e tij në verë. E ardhmja e 32-vjeçarit duket se do të jetë larg Evropës, pasi klubet nga Arabia Saudite janë në garë për t'i fituar shërbimet e tij. Al Nass është favorit për të, por në garë janë edhe Al-Ettifaq dhe Al-Ittihad. Ekziston mundësia që Casemiro ta shkëpusë kontratën me Unitedin dhe të largohet si lojtarë i lirë.

Chelsea arrin marrëveshje me trajnerin e ri

Chelsea pritet së shpejti ta zyrtarizojë trajnerin e ri, pasi marrëveshja tanimë është arritur. Pas largimit të Mauricio Pochettinos, drejtimin e skuadrës pritet ta marrë trajneri

italian Enzo Maresca. Ka qenë gazetari italian Fabrizio Romano që ka konfirmuar se marrëveshja është arritur, ku Maresca do të nënshkruajë një kontratë pesëvjeçare. "Chelsea ka rënë

dakord ta emërojë Enzo Maresca trajner të ri. Ja ku po shkojmë. Kuptoni se marrëveshja është bërë tani me kontratë të vlefshme deri në qershor 2029. Marrëveshje pesëvjeçare. Ai,

gjithashtu, do të përfshijë një opsion për t'u zgatur deri në qershor 2030. Chelsea ka vendosur ta paguajë një klauzolë largimi të Marescas nga Leicesteri", ka shkruar Romano.

Kësisoj për Marescan do të jetë aventura e katërt në Angli, pasi para se të emërohej trajner i Leicesterit, ai ishte asistent te West Ham Unitedi dhe Manchester City.



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE

"Ambienti" SH.A.PEJË

NR 766

DATA 28.05.24

Kompania Regjionale e Mbeturinave "Ambienti" Sh.A. Pejë
Me adresë Rr.Xhem Sadrija pn. Fusha e Pejës-Tranzit KK Pejë

Bazuar në ligjin e Punës: LIGJI Nr. 03/L-212 sipas neni 8, dhe në bazë të Udhzimit Administrativ MFPT- NR 01/2024, Kryeshefi Egzekutiv i Kompanisë Regjionale të Mbeturinave "Ambienti" Sh.A. Pejë me datë 29.05.2024, shpall konkurs të jashtëm për këto vende të punës :

KONKURS

Pozita : 6 Puntor fizik në mbledhjen e hedhurinave

Vendi punës Pejë:

Kohëzgjatja e periudhës provuese është 6 muaj me mundësi vazhdimi sipas kontratave të ligjit të punës.

Paga Bruto 478.00 euro , plusë shujtja 88 euro Bruto

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Kryen të gjitha punët në mbledhjen dhe ngarkimin e hedhurinave.
2. Mbledh hedhurinat dhe bënë zbrazjen e Kontenjerve dhe mjeteve tjera për hedhurina apo çesëve nga shfrytëzuesit e shërbimeve në sektorin privat dhe shtetëror.
3. Pas zbrazjes së Kontenjerve dhe mjeteve tjera, është i obliguar t'i kthej ato në vende të caktuara dhe për të të ketë kujdesë.
4. Është përgjegjës për kryerjen e punëve në mënyrë efikase dhe kualitative, për sjellje korrekte me qytetarët-shfrytëzuesit e shërbimeve.
5. Është i obliguar të mbaj uniformen e ndermarrjes dhe pajisjet e tjera të punës.
6. Kryen pune bazuar në kontratën e punës por edhe punë tjera me urdhëres të Shoferit dhe Kryepunëtorit.
7. Për mos respektimin e pikave të lartecaktuara i përgjigjet drjtëpërdrejtë, Kryeshefit Ekzekutiv.

a. Kushtet e përgjithshme :

1. Një CV të detajuar
2. Çertifikata që kandidati nuk është nën hetime
3. Letër motivimi
4. Kopja e leternjoftimit
5. Çertifiata mbi gjendjen shëndetsore (kërkohet pas pranimit në punë)

b. Kushtet e veçanta :(kualifikimet profesionale)

1. Të ketë njohuri për shkrim dhe lexim përparësi shkollimi fillorë
2. Aftësi fizike dhe psikike të deshmuar
3. Përparësi përvojë pune e deshmuar.
4. Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë;

Pozita : 2 Punëtorë Roje

Vendi punës Sferkë e Thatë KK Pejë:

Kohëzgjatja e periudhës provuese është 6 muaj me mundësi vazhdimi sipas kontratave të ligjit të punës.

Paga Bruto 406.30 euro , plusë shujtja 88 euro Bruto

Sigurimi i objektivit (Roje)

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësisë të punës:

1. Përcjellë hyrje-daljen e palëve, punëtorëve dhe automjeteve
2. Daljen e punëtorëve pa leje paraprake, të parakohshme i evidenton në libër të veçant;
3. Palët duhet t'i japë fletëhyrjen dhe i orienton për në shërbimet për të cilat janë të interesuara;
4. Është i obliguar për sjellje korrekte me pale dhe për qëndrim në vendin e tij të punës;
5. Bënë sigurimin e objektivit në të cilin është përcaktuar në bazë të planit mujor;
6. Bënë shiqimin e gjendjes së objektivit dhe mjeteve kundër zjarrit dhe rregullësis së tyre;
7. Kontrollon dhe largon personat e paautorizuar dhe të dyshimt që ndodhen afër objektivit.
8. Ndërmerr masat e nevojshme në mbrojtjen e objektivit nga dukurit natyrore dhe për këtë lajmëron menjëherë shërbimet e specializuara;
9. Pranon dhe dorëzon ndërrimin dhe për gjendjen e objektivit e informon punëtorin e sigurimit të radhës;
10. Obligohet që në vendin e punës të mbajë uniformën;

a. Kushtet e përgjithshme :

1. CV ;
2. Çertifikatë që kandidati nuk është nën hetime ;
3. Letër motivimi ;
4. Kopja e leternjoftimit ;
5. Çertifikatë mbi gjendjen shëndetsore ;

b. Kushtet e veçanta: (kualifikimet profesionale)

- a. Shkollimin fillor përparësi shkollimi i mesëm;
- b. Përparësi janë certifikimet në siguri
- c. Aftësi shumë të mira organizative
- d. Njohja e punës me kompjuter.
- e. Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë.

Mënyra e Aplikimit:Dokumentacioni duhet të dërgohet në e-mailin krmambientikonkurset@gmail.com

Data e për aplikim është nga 29.05.2024 deri me 13.06.2024 ora 12:00. Dokumentacioni që mbërrin pas afatit dhe i pakompletuar do të konsiderohet i pavlefshëm. Dokumentet origjinale mund të kërkohen, sipas nevojës. Vetëm kandidatët e selektuar për listën e ngushtë do të kontaktohen.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "Gëzim M. Berisha" B.I. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810948234 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da "Gëzim M. Berisha" B.I. Pristine, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810948234 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that "Gëzim M. Berisha" B.I. with headquarters in Prishtina, has come to the decision to quit its business: 810948234 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Jahir Temaj shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme "Ymer Prizreni" Prizren.

-Fitim Bytyqi shpall të pavlefshme 4 dëftesat Q.K. "11 Marsi" Prizren.

-Liberta Lacaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Bajram Curri " Romaje.

-Riza Hazeraj shpall të pavlefshme diplomën shme "Ymer Prizreni " Prizren.

-Taulant Selmani shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e shkollës së mesme të Gjimnazit "Gjon Buzuku" Prizren.

-Gazmend Dauti nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.t. "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

-Shar Shehu nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpazj. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , në lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

